

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – koleji i përbërë nga gjyqtarët: Erdogan Haxhibeqiri, kryetar, Gyltene Sylejmani dhe Jelena Krivokapiq, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit B. G., nga ..., të cilin me autorizim e përfaqëson N. Q., avokat nga ..., kundër të paditurës Korporata Elektro Energjetike (KEK), Distrikti në Prizren, objekti i kontestit anulimi i vendimit mbi shkëputjen e kontratës së punës dhe kompensimin e të ardhurave personale, duke vendosur përkitazi me revizionin e paditësit të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, AC.nr.4184/2016 datë 09.11.2018, në seancën e kolegjit e mbajtur më 20 mars 2019, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

Refuzohet i i pabazuar revizioni i paditësit, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, AC.nr.4184/2016 datë 09.11.2018.

### A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, AC.nr.4184/2016 datë 09.11.2018, është refuzuar ankesa e paditësit si e pabazuar dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, C.nr. 1234/2015 datë 09.6.2016, me të cilin është refuzuar kërkesëpadia e paditësit ku ka kërkuar të anulohet vendimi i të paditurës KEK, Distrikti në Prizren, për shkëputjen e kontratës së punës me nr. 1048/1 të datës 18.6.2012 dhe vendimi me nr. 5293 i datës 09.7.2012 dhe të detyrohet e paditura të kthejë paditësin në vendin e punës si elektrikist i matjeve, duke ia njohur të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës si dhe të kompensoj të ardhurat personale nga data 18.6.2012 deri më 15.5.2016, në shumën në lartësi prej 26.558,31 € me kamatë ligjore me kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Kundër aktgjykimit të shkallës së dytë paditësi me kohë ka paraqitur revizion duke goditur aktgjykimin e shkallës së dytë për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikimi të gabuar të së drejtës materiale me propozim që të dy aktgjykimet të ndryshohen dhe të aprovohet kërkesëpadia e paditësit apo të njëjti të prishet dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Përgjigje në revizion nuk ka pasur.

Duke vlerësuar aktgjykimin e goditur në bazë të nenit 215 të LPK, Gjykata Supreme e Kosovës ka gjetur se:

Revizioni i paditësit është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës del se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune të paditur në bazë të kontratës së punës nr. ... të datës 1.1.2012, me kohëzgjatje të kontratës prej 1.1.2012 deri më 31.12.2012 dhe atë në detyrat e punës elektrikist i matjeve (njehësorve) ... Me vendimin e të paditurës me nr. ..., të datës 18.6.2012 paditësit i është shkëputur kontrata e punës prej datës 18.6.2012 për shkak se i njëjti ka bërë pranimin teknik të njehsorit elektrik trefazor me nr. ..., dhe grup tarifor ..., të konsumatorit N.H.SH Restorant "G...", kështu që ka hyrë në CCP dhe është regjistruar si konsumator i ri, pranimi teknik është bërë jo në mënyrë të rregullt dhe është kategorizuar në kategorinë e konsumatorëve komercial në fuqi deri më 15 KW për derisa ky hyn në kategorinë e konsumatorëve të mëdhenj me fuqi të njëkohshme mbi 15 KV, me çka ka bërë shkelje të rënda të detyrave të punës nga neni 7 paragrafi 7.1 nën. paragrafi (1) të Kodit Disiplinor nr. (2) të paditurës. Kundër këtij vendimi paditësi ka paraqitur ankesë të cilën organi i shkallës së dytë të paditurës me vendimin nr. ..., të datës 09.7.2012 ka refuzuar si të pabazuar.

Në këtë gjendje të vërtetuar faktike gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se e paditura ndërprerjen e njëanshme të kontratës së punës ka bërë për shkak se paditësi ka bërë shkelje të rënda të detyrave të punës nga neni 70 paragrafi 1.4.1 të Ligjit të Punës dhe është shkëputur kontrata e punës në bazë të procedurës disiplinore që është zhvilluar në pajtim me aktet e brendshme të të paditurës dhe atë në pajtim me Kodin Disiplinor nr. 2 e cila ka qenë në fuqi. Në bazë të kësaj gjendje të vërtetuar faktike gjykata e shkallës së parë ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurë ankimore ka refuzuar ankesën e paditësit duke pranuar në tërësi si të drejta konstatimet faktike dhe vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë. Gjykata e shkallës së dytë vlerëson se organi disiplinor i të paditurës ka gjetur se paditësi ka bërë shkelje të rënda të detyrave të punës nga neni 70 paragrafi 1 pika 1.4.1 të Ligjit të Punës për çka i është shqiptuar masa disiplinore shkëputje e kontratës së punës.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se gjykata e shkallës së dytë në gjendjen e vërtetuar faktike në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të

drejtën materiale kur ka refuzuar ankesën e paditësit dhe ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë duke dhënë arsye të mjaftueshme për faktet relevante për gjykim të drejtë të kësaj çështje juridike të cilat i pranon edhe gjykata e revizionit.

Gjykata Supreme e Kosovës, ka vlerësuar si të pabazuar thëniet e revizionit të paditësit se aktgjykimin i goditur është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n), nga arsyet se gjykata e shkallës së dytë në procedurë të vendosjes sipas ankesës dhe se në aktgjykimin e saj jep arsye të mjaftuara dhe bindëse për marrjen e një vendimi të tretë e të ligjshëm, të cilat janë të pranuar edhe nga Gjykata Supreme. Gjykata e shkallës së dytë drejt ka vlerësuar se organi disiplinor i të paditurës ka gjetur se paditësi ka bërë shkelje të rëndë të detyrave të punës dhe atë ndaj të njëjtit disa herë i janë shqiptuar masa disiplinore.

Gjykata Supreme e Kosovës, ka vlerësuar si të pabazuara thëniet e revizionit se nuk është vërtetuar se paditësi ka bërë shkelje të rënda të detyrave të punës nga fakti se në procedurë të zhvilluar pranë organit disiplinor të paditurës e në pajtim me Kodin Disiplinor nr. 2 është vërtetuar se paditësi ka bërë pranimin e njësorit elektrik të konsumatorit N.H.SH Restorant “G” dhe ka regjistruar si konsumator të ri. Pranimi teknik është bërë në mënyrë jo të rregullt dhe kategorizimi i konsumatorit është bërë në mënyrë jo të rregullt çka është bërë shkelje nga neni 7 paragrafi 7.1 nën.paragrafi (1) të Kodit Disiplinor të paditurës e që kjo paraqet si shkelje nga neni 70 paragrafi 1 pika 1.4.1 të Ligjit të Punës e që si pasojë ka shkëputjen e kontratës së punës.

Nga arsyet e dhëna më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimin në bazë të nenit 222 të LPK.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Rev.nr.50/2019, më 20 mars 2019

Kryetari i kolegjit,  
Erdogan Haxhibeqiri